



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 52, datë 28.12.2020

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“NDËRTIMI I LANDFILLIT, INCENERATORIT DHE REHABILITIMI I
VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Ndërtimi i landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues shoqërinë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.14, datë 17.05.2019, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

